



Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L-038, neni 14, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 17 dhe 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 30 qershor 2022, nxori këtë

RREGULLORE PËR PROJEKTET SHKENCORE

Neni 1

1. Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e organizimit dhe e punës në projektet shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejme Akademia) dhe të pjesëmarrësve në këto projekte.

Neni 2

1. Projektet shkencore propozohen nga anëtarët e Akademisë dhe miratohen në seksionet përkatëse;
2. Propozimet e seksioneve i paraqiten Kryesisë së Akademisë për shqyrtim dhe Kuvendit për miratim;
3. Kuvendit të Akademisë i paraqiten për miratim propozimet e plota për projektet, të përcaktuara në nenin 3 paragrafi 1.
4. Projektet e miratuara nga Kuvendi i Akademisë janë pjesë e programit të punës së saj;
5. Në raste të veçanta, projektet mund të propozohen edhe nga Kryesia e Akademisë dhe të miratohen në mbledhjet e rregullta të saj. Pas miratimit, Kryesia merr përsipër realizimin e tyre;
6. Kryesia e Akademisë mund t'u propozojë projekte shkencore seksioneve përkatëse;
7. Projektet e Akademisë janë afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, por jo më shumë se pesëvjeçare;
8. Në raste të veçanta afati shtesë i realizimit të projekteve shkencore përcaktohet me vendim të Kryesisë;
9. Bartës të projekteve duhet të jenë anëtarët e Akademisë;
10. Akademia realizon projekte të përbashkëta edhe me akademitë me të cilat ka bashkëpunim;
- 10.1. Mënyra e realizimit të tyre rregullohet në bazë të marrëveshjeve/protokolleve të bashkëpunimit, apo me marrëveshje të veçantë;

11. Akademia realizon projekte edhe me institucione të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- 11.1. Mënyra e realizimit të tyre përcaktohet me marrëveshje të veçantë;
- 11.2. Në projektet brenda vendit bartëse e projektit është Akademia;
- 11.3. Në projektet nga bashkëpunimi ndërkombëtar bartësi i projektit përcaktohet me marrëveshje të veçantë.

Neni 3

1. Projektet e paraqitura duhet të përmbajnë:
 - 1.1. Emërtimin dhe arsyeshmërinë shkencore;
 - 1.2. Bartësit e projektit;
 - 1.3. Strukturën organizative të projektit;
 - 1.4. Numrin e personave të angazhuar në projekt;
 - 1.5. Përshkrimin gjithëpërfshirës shkencor të projektit;
 - 1.6. Kohëzgjatjen e projektit;
 - 1.7. Kompetencën shkencore të hulumtuesve pjesëmarrës dhe të institucioneve partnere, nëse ka;
 - 1.8. Planin e hulumtimit;
 - 1.9. Rezultatet e pritshme të projektit dhe relevancën e tyre;
 - 1.10. Planin e përgjithshëm buxhetor dhe arsyeshmërinë e fondeve të kërkuara.
2. Dosja e propozimit të projektit duhet të jetë e plotë dhe përfshin:
 - 2.1. Formularin e plotësuar për aplikim, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
 - 2.2. Të dhënat e institucionit partner vendës dhe ndërkombëtar për aplikim në projekte të përbashkëta;
 - 2.3. Deklaratën e personit juridik të institucionit partner, nëse ka;
 - 2.4. CV-të e pjesëmarrësve në projekt.

Neni 4

1. Puna në projekte përmyllet me raport përfundimtar të cilin e harton bartësi i projektit;
 - 1.1. Pjesë përbërëse e raportit përfundimtar janë deklarata e bartësit të projektit dhe deklaratat e të angazhuarve në projekt;
 - 1.2. Deklarata e bartësit të projektit duhet të përmbajë mënyrën e realizimit dhe shkallën e angazhimit të pjesëmarrësve në projekt;
 - 1.3. Deklarata e të angazhuarve duhet të përmbajë kontributin e tyre në projekt;

2. Raporti përfundimtar përfshin rezultatet e arritura të hulumtimeve, prezantimet në konferenca, publikimet në revista ose në botime të veçanta;
3. Për projektet disavjeçare paraqiten raporte vjetore të punës;
4. Në raste të caktuara, për projekte mund të paraqiten edhe raporte gjashtëmujore;
5. Bartësi i projektit e paraqet raportin e punës në seksionin e Akademisë;
6. Pas miratimit të raportit përfundimtar ose periodik të projektit nga seksioni, i njëjti dërgohet për miratim në Kryesinë e Akademisë;
7. Pas miratimit të raportit përfundimtar ose periodik të projektit, Kryesia e Akademisë merr vendim për realizimin e pagesave të të angazhuarve në projekt.

Neni 5

1. Rezultatet e projekteve publikohen në kuadër të veprimtarisë botuese të Akademisë ose në platforma ndërkombëtare;
2. Pagesa e publikimit të rezultateve të projekteve bëhet në përputhje me Rregulloren për honoraret e autorëve të veprimtarisë botuese të Akademisë;
3. Për projekte përjashtohet mundësia e pagesave të dyfishta;
 - 3.1. Puna menaxheriale dhe ajo hulumtuese në projekte paguhet me paushallët e paraparë me projektin e miratuar;
 - 3.2. Realizimi i pagesave sipas nënparagrafit 3.1. të këtij neni bëhet me vendim të Kryesisë së Akademisë, duke u mbështetur në rezultatet e projektit;
 - 3.3. Realizimi i pagesave për personat e angazhuar në projekte bëhen nga Kryesia duke u mbështetur në shkallën e angazhimit dhe përgjegjësisë për të angazhuarit;
 - 3.4. Botimi i rezultateve të projekteve paguhet sipas Rregulloreve për honoraret e autorëve të veprimtarisë botuese të Akademisë.

Neni 6

1. Akademia gjithashtu mbulon shpenzimet e projekteve si në vijim:
 1. Vizitat afatshkurta me qëllim hulumtimi;
 2. Pjesëmarrja në konferenca, në të cilat prezantohen rezultatet e projekteve;
 3. Koutizimi për publikimin e rezultateve të projekteve në revista dhe konferenca ndërkombëtare;

4. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe të qëndrimit për të angazhuarit nga jashtë vendit;
5. Shpenzimet e punës në terren.

Neni 7

1. Forma e aplikimit për projekte shkencore paraqitet në formularin e aplikimit që është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 8

1. Rezultatet e projekteve shkencore botohen në gjuhën shqipe, ndërsa me propozim të bartësit të projektit mund të botohen edhe në gjuhë të tjera, me aprovim të Kryesisë së ASHAK-ut.

Neni 9

1. Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

Kryetari i Akademisë
Akademik Mehmet Kraja

